

V E N D I M
Nr.223, datë 13.4.2001

**PËR VLERËSIMIN CILËSOR TË MARKAVE TË CIGAREVE TË PRANISHME NË
TREGUN SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15, të ligjit nr.8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve” dhe të nenit 3, të ligjit nr.8716, datë 15.12.2000 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8437, datë 28.12.1998 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Prodhuesit dhe importuesit e produkteve të duhanit, regjistrojnë markat e tyre në regjistrin e markave, në Agjencinë Kombëtare të Duhan-Cigareve.

2. Regjistri i markave përmban të dhëna për:

- a) personin, fizik/juridik, prodhues ose importues të produkteve të duhanit;
- b) emërtimin tregtar, të produkteve të duhanit të prodhuar apo importuar;
- c) treguesit fiziko-kimikë të produkteve të duhanit;
- ç) treguesit shijorë të produktit të duhanit;
- d) të dhëna për kategorinë e produktit të duhanit.

3. Përcaktimi i treguesve fiziko-kimikë dhe kondensatit të tymit të duhanit dhe të produkteve të duhanit, bëhet në Institutin e Kërkimeve Ushqimore, sipas standardeve shqiptare dhe atyre të Organizatës Ndërkombëtare të Standardeve (ISO).

4. Vlerësimi cilësor i të gjitha markave të produktit të duhanit, të pranishme në tregun shqiptar, bëhet nga komisioni i specialistëve të degustimit. Anëtarët e këtij komisioni zgjidhen sipas këtyre kritereve:

- Të jetë duhanpirës.
- Të jetë specialist i lartë dhe të ketë përvojë pune, mbi 5 vjet, në industrinë ushqimore.
- Të ketë njohuri për lidhjen ndërmjet përbërjes së harmanëve, treguesve fiziko-kimikë dhe lidhjes së tyre me treguesit degustativë.

Komisioni përbëhet nga 11 anëtarë, të cilët janë përfaqësues të:

- Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit;
- Ministrisë së Financave;
- Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë (sektori i mbrojtjes së konsumatorit);
- Institutit të Kërkimeve Ushqimore;
- Institutit të Duhanit, Cërrik;
- Shoqatës së Industrialistëve të Duhanit;
- Fabrikave të duhan-cigareve dhe specialistë me përvojë në fushën e prodhimit të cigareve.

Propozimet emërore bëhen nga institucionet e mësipërme dhe miratohen nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit, i cili emëron edhe kryetarin e këtij komisioni. Anëtarët e komisionit zëvendësohen, çdo 2 vjet, me anëtarë të rinj. Çdo ndryshim në përbërjen e komisionit gjatë funksionimit, miratohet nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

5. Komisioni, në mbledhjen e tij të parë njihet me dokumentet përkatëse zyrtare, udhëzimet, rregulloret, procedurat e funksionimit dhe zgjedh sekretarin e komisionit.

6. Komisioni ka për detyrë:

- të kryejë vlerësimin cilësor të të gjitha markave të cigareve, të pranishme në tregun shqiptar, bazuar në mostrat e sjella nga subjekti;
- të përcaktojë vetitë shijore dhe t'i interpretojë ato;
- të bëjë kategorizimin e markave të cigareve;
- të bëjë, çdo 6 muaj, rivlerësimin e markave të cigareve dhe krahasimin e tyre, me mostrën e miratuar;

- të organizojë degustimin e fshehtë. Markat e cigareve mbulohen dhe mostrat kodifikohen.

7. Në një seancë degustimi, të degustohen deri me 4 mostra cigaresh. Kriteret e vlerësimit të

treguesve shijorë të markave të cigareve, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Ministrisë së Financave.

8. Vendimi i komisionit i shoqëruar me analizat fiziko-kimike dhe të kondensatit të tymit, u bëhen të ditur subjekteve të interesuara dhe Ministrisë së Financave. Procedurat dhe vendimet e këtij komisioni, arkivohen në zyrën e arkiv-protokollit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

9. Shpenzimet për kryerjen e degustimit, pagesa e anëtarëve të komisionit dhe tarifat e analizave kimiko-fizike e të kondensatit të tymit, përcaktohen me udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe të Ministrisë së Financave dhe mbulohen nga subjektet e interesuara.

10. Ministria e Financave njofton të gjitha subjektet, importuese dhe prodhuese të cigareve, për të bërë regjistrimin e markave të cigareve, që prodhojnë apo importojnë, në Agjencinë Kombëtare të Duhan-Cigareve.

11. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta